

VENDIM
Nr. 789, datë 7.10.2020

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR, TË PASURISË 1/162, ZONA KADASTRALE 8561, KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të truallit, me sipërfaqe 3 556.1 (tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë një) m², dhe objekte në të, me sipërfaqe 1 174.1 (një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë pikë një) m², në zonën kadastrale 8561, me numër pasurie 1/162, Korçë, sipas planit të rilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përdoret për kryerjen e aktivitetit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë.

3. Drejtoria Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

